

Ilmije Kuqi, PhD¹

UDC: 364.63-027.553:28

**MEKANIZMAT E MBROJTJES SË FAMILJES NGA DHUNA SIPAS
PERSPEKTIVËS ISLAME**

**МЕХАНИЗМИ ЗА ЗАШТИТА НА СЕМЕЈСТВОТО ОД
НАСИЛСТВО СПОРЕД ИСЛАМСКАТА ПЕРСПЕКТИВА**

**MECHANISMS OF PROTECTING THE FAMILY FROM VIOLENCE
ACCORDING TO THE ISLAMIC PERSPECTIVE**

Abstract

This paper analyzes the mechanisms for protecting families from violence according to the Islamic perspective, focusing on two main aspects: violence prevention and its treatment after occurrence. The study is based on analysis of Quranic texts, Hadiths, and interpretations by Islamic scholars, highlighting Islam's comprehensive approach to domestic violence. The findings show that Islam offers an integrated system for preventing violence through core values such as mercy, respect, and mutual understanding. In cases where conflicts arise, Islamic legislation provides concrete measures ranging from dialogue and mediation to the dissolution of marriage as a last resort. Through this systematic approach, it aims to demonstrate how Islamic legislation not only prohibits domestic violence, but also provides effective mechanisms for maintaining family harmony and stability.

Keywords: *family, violence, Islam, protection, mechanisms.*

Hyrje

Dhuna familjare përbën një nga sfidat më serioze me të cilat përballet shoqëria bashkëkohore, duke kërcënuar stabilitetin e familjes dhe mirëqenien e anëtarëve të saj. Në këtë kontekst, është thelbësore të eksplorojnë qasjet dhe

¹ Prof. ass. dr. Ilmije Kuqi, Institucioni: Fakulteti i Studimeve Islame - Prishtinë.

zgjidhjet që ofron feja islame për parandalimin dhe trajtimin e këtij fenomeni. Ky studim synon të analizojë mekanizmat që ofron Islami për mbrojtjen e familjes nga dhuna, duke u bazuar në burimet parësore të legjislacionit islam - Kuranin dhe Sunetin.

Punimi është strukturuar në dy pjesë kryesore. Pjesa e parë trajton aspektin parandalues, duke analizuar tekstet e Sheriatit dhe parimet e tij në lidhje me organizimin e marrëdhënieve familjare dhe rregullat për parandalimin e dhunës. Pjesa e dytë fokusohet në qasjen e Islamit ndaj situatave ku dhuna ka ndodhur tashmë, duke shqyrtuar mekanizmat për zgjidhjen e konflikteve dhe rivendosjen e harmonisë familjare.

Rëndësia e këtij studimi qëndron në kontributin që ai jep për të kuptuar më mirë qasjen gjithëpërfshirëse të Islamit ndaj dhunës familjare dhe në identifikimin e zgjidhjeve praktike që mund të aplikohen për ruajtjen e harmonisë dhe stabilitetit familjar.

Pjesa e parë: Parandalimi i dhunës familjare në tekstet e sheriatit dhe parimet e tij

Legjislacioni islam rregullon jetën e individëve, duke përfshirë marrëdhëniet me Zotin dhe me të tjerët. Duke qenë që njeriu është një qenie sociale nga natyra, integrimi i tij brenda komunitetit kërkon që ai të gëzojë të drejta dhe të përmbushë detyrat, të cilat shpesh mund të çojnë në konflikt interesash dhe mosmarrëveshje rreth tyre. Por, Legjislacioni islam vendos kufijtë e marrëdhënieve shoqërore dhe specifikon rregullat e duhura për t'i menaxhuar ato. Ai gjithashtu jep udhëzime për mënyrën e ruajtjes së marrëdhënieve familjare në përputhje me mësimet dhe udhëzimet e Islamit, për të siguruar një mjedis social ku mbizotëron siguria dhe qëndrueshmëria, për të arritur qëllimin e krijimit të njeriut, për ta lehtësuar ushtrimin e misionit të tij të adhurimit të Allahut dhe mbajtjen e rolit të tij si mëkëmbës në Tokë.

Një: Rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet individëve në përputhje me vlerat dhe mësimet islame

Mësimet islame theksojnë nevojën e zbatimit të masave për ruajtjen e shoqërisë dhe sigurisë së saj. Kjo arrihet duke demonstruar vlerën e mëshirës, e cila nuk është një reagim emocional, por një sjellje që manifestohet përmes marrëdhënieve të njeriut me të tjerët. E njëjta gjë vlenë edhe për refuzimin e dhunës në të gjitha format e saj dhe ndërprerjen e çdo gjëje që çon drejt saj. Përveç kësaj, ekzistojnë vlera njerëzore që kontrollojnë sjelljen e individit në shoqëri, si durimi dhe toleranca. Këto virtyte janë të rëndësishme për të ruajtur entitetin e shoqërisë, qetësinë e familjes dhe sigurinë e individëve.

1. Aktivizimi i vlerës së mëshirës si besim dhe sjellje

Mëshira ka një status të veçantë dhe është thelbësore në Islam dhe ka rol të rëndësishëm në ruajtjen e marrëdhënieve të shëndosha ndërmjet individëve. Në fenë islame dhe mësimet e tij, mëshira i kapërcen të gjitha cilësitë e tjera dhe ka përparësi në të gjitha marrëdhëniet, madje është një nga karakteristikat e ligjit islam dhe një karakteristikë që duhet të ndiqet nga çdo individ, veçanërisht brenda familjes. Kjo vlerë theksohet në shumë ajete të Kuranit dhe hadithe të Pejgamberit a.s., ku nënvizohet se të gjithë besimtarët duhet të jenë të përkushtuar për të treguar mëshirë, duke kontribuar kështu në një shoqëri të qetë dhe paqësore. Pejgamberi a.s. ka thënë:

*“Shembulli i besimtarëve në dashurinë, mëshirën dhe ndihmën ndaj njëri-tjetrit është si trupi. Nëse një pjesë e tij ankon, të gjitha pjesët e tjera ndjen dhimbje dhe temperaturë.”*²

Ky hadith thekson se mëshira dhe ndihma ndaj të tjerëve është esenca e një shoqërie të shëndoshë, ku çdo individ është i lidhur me njëri-tjetrin dhe kujdeset për mirëqenien e të gjithëve.

Po ashtu, Pejgamberi a.s. ka thënë:

*“Mëshiruesit do të mëshirohen nga Allahu.”*³

Ky hadith përforcon rëndësinë e mëshirës si një veprim i domosdoshëm për të siguruar marrëdhënie harmonike dhe për të parandaluar dhunën.

Këto hadithe, si dhe shumë të tjera, pasqyrojnë rëndësinë e mëshirës në Islam. Ajo është një besim dhe një sjellje që ndihmon në ruajtjen e harmonisë dhe paqes ndërmjet individëve dhe është një faktor kyç për formimin e një shoqërie pa dhunë dhe pa konflikte. Besimi i një myslimani kërkon që ai të jetë i stolitur me cilësinë e mëshirës, sepse kjo është thelbësore për qëndrueshmërinë dhe suksesin e tij, si në aspektin shpirtëror ashtu edhe në atë social. Ndërsa mungesa e mëshirës në zemrat dhe veprimet e myslimanëve është një defekt në të menduarit e tyre dhe tregon devijim nga udhëzimet islame, duke çuar në sjellje që shkatërrojnë marrëdhëniet shoqërore dhe krijojnë tensione dhe dhunë. Për këtë arsye, mëshira është aktivizuar si një atribut hyjnor i dhuruar nga Zoti për robërit e Tij, në mënyrë që të rregullojë sjelljen e individëve dhe të sigurojë një valvulë sigurie për ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë sociale. Mëshira kontribuon në krijimin e marrëdhënieve të shëndosha, dinjitoze dhe paqësore brenda shoqërisë dhe familjes.

2. Refuzimi dhe ndalimi i dhunës

Dhuna është e kundërta e butësisë. Në terminologji, dhuna është çdo veprim që shkakton dhimbje ose dëm ndaj një tjetri, qoftë fizikisht apo emocionalisht. Feja islame ka ndaluar çdo formë dhune ndaj anëtarëve të familjes. Mëshira dhe respekti janë vlerat që duhet të udhëheqin marrëdhëniet ndërmjet

² el-Buhari, nr: 6011; Muslimi, nr: 2586.

³ Ebu Davudi, nr: 4941; et-Tirmidhi, nr: 1924, dhe thotë: “Ky hadith është i mirë, i saktë”.

bashkëshortëve, prindërve dhe fëmijëve, si dhe të tjerëve brenda familjes. Dhuna, e cila mund të shfaqet në forma të ndryshme, është e dënueshme dhe e papranueshme sipas mësimave islame. Pejgamberi a.s. ka thënë:

*“Kush nuk mëshiron njerëzit, Zoti nuk e mëshiron.”*⁴

Ky hadith e ndalon çdo formë dhune, duke përfshirë dhunën fizike, psikologjike dhe verbale.

Pejgamberi a.s. ka vendosur kufijtë e marrëdhënies ndërmjet myslimanëve dhe kontrolleve të sjelljeve të tyre. Nga Ebu Hurejra r.a. transmetohet se i Dërguari i Allahut, a.s., ka thënë:

*“Mos e keni zili njëri-tjetrit, mos e mashtroni njëri-tjetrit në tregti, mos e urreni njëri-tjetrit, mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit, mos i ndërhyti njëri-tjetrit në shitblerje por bëhuni robër të Allahut dhe vëllezër në mes vete. Myslimani është vëlla i myslimanit, ai nuk i bën padrejtësi, nuk e tradhton, nuk e gënjen, nuk e ofendon. Devotshmëria është këtu (bën me shenjë në gjoksin e tij) dhe mjafton e keqja ta nënçmosh vëllain tënd mysliman. Çdo mysliman e ka të ndaluar gjakun, pasurinë dhe nderin e myslimanit tjetër.”*⁵

Ky mesazh i qartë thekson ndalimin e dhunës dhe të gjithë formave të padrejtësisë brenda familjes dhe shoqërisë, duke siguruar që paqja dhe harmonia të mbizotërojnë.

3. Përmbajtja vlerave islame në kundërpërgjigje

Legjislacioni islam vë theks të veçantë në vlerat e mirëkuptimit dhe dhembshurisë, veçanërisht në kontekstin e marrëdhënies familjare. Këto vlera janë jetike për të parandaluar armiqësitë ndërmjet anëtarëve të familjes dhe për të nxitur trajtimin e mirë, durimin dhe përballimin e çdo dëmtimi që mund të ndodhë. Durimi, një nga vlerat më të rëndësishme të Islamit, është kyç për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit brenda familjes dhe shoqërisë.

Në Islam, durimi konsiderohet si një nga shenjat e besimit të fortë. Sa më i madh të jetë durimi i një besimtari, aq më i lartë është niveli i tij i besimit. Allahu i Madhëruar i do ata që tregojnë durim dhe u premtan shpërblim të shumëfishtë. Allahu e ka përmendur durimin në shumë ajete të Kuranit, gjithmonë në kontekstin e lavdërimit. Siç thuhet në ajetin kuranor:

*“Të durueshmëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë!”*⁶

Pejgamberi a.s. gjithashtu thekson vlerën e durimit, duke e konsideruar atë si një nga dhuratat më të çmuara që i është dhënë njeriut. Ai thotë:

*“Askujt nuk i është dhënë dhuratë më e mirë dhe më e gjerë se sa durimi.”*⁷

Kjo thënie tregon qartë vlerën e jashtëzakonshme që ka durimi në jetën e një besimtari.

⁴ Muslimi, nr: 2319.

⁵ Muslimi, nr: 2564.

⁶ ez-Zumer: 10.

⁷ Muslimi, nr: 1053.

Durimi manifestohet në forma të ndryshme në jetën e njeriut. Kur është fjala për marrëdhëniet me Zotin, durimi shfaqet në përmbushjen e detyrimeve fetare dhe shmangien e mëkateve. Ndërsa në marrëdhëniet ndërnjerëzore, durimi shprehet përmes reagimit të matur ndaj padrejtësive, duke shmangur zemërimin dhe hakmarrjen, dhe duke zgjedhur faljen dhe tolerimin si mënyra për të përballuar situatat e ndërlikuara.

Në kontekstin familjar, durimi është një element kyç për ruajtjen e stabilitetit dhe harmonisë. Kur lindin probleme apo keqkuptime, durimi ndihmon në mbajtjen e qetësisë dhe gjetjen e zgjidhjeve paqësore. Përballimi i vështirësive me durim, kontrolli i zemërimit dhe praktikimi i faljes kontribuojnë në forcimin e lidhjeve familjare. Kurani na mëson të përgjigjemi ndaj të keqeve me të mirë, duke thënë:

“Ti të keqen kthe me më të mirën.”⁸

Ky parim është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin familjar, ku reagimi me mirësi, pavarësisht rrethanave të vështira, ndihmon në ruajtjen e unitetit dhe paqes.

Të gjitha këto mësimet janë të rëndësishme jo vetëm për formimin e një shoqërie të shëndetshme dhe harmonike, por edhe për ruajtjen e stabilitetit dhe paqes brenda familjes. Vlerat e durimit, dhembshurisë dhe respektit janë thelbësore për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të paqes në çdo familje. Shpërblimi për respektimin e këtyre vlerave është shumë më i madh, ndërsa pasojat për dhunën dhe shkeljen e këtyre parimeve janë të rënda. Legjislacioni islam orienton individët të reagojnë me durim dhe respekt, për të ndihmuar në krijimin e një ambienti paqësor dhe harmonik brenda familjeve dhe shoqërive.

Dy: Udhëzimi i Islamit në ruajtjen e marrëdhënieve familjare

Legjislacioni islam i ka kushtuar vëmendje të veçantë dhe gjithëpërfshirëse familjes, duke e konsideruar atë si bërthamën e shoqërisë. Në këtë kontekst, ai ka vendosur rregulla dhe udhëzime të qarta për organizimin e marrëdhënieve familjare, duke filluar që nga krijimi i familjes e deri te arritja e qëllimeve të saj fisnike. Qetësia dhe dashuria përbëjnë themelin e ndërtimit të familjes islame dhe shërbejnë si mbrojtës të stabilitetit të saj. Duke pasur parasysh këtë, Legjislacioni islam ka vendosur rregulla që ruajnë ekzistencën dhe qëndrueshmërinë e familjes, duke mos lënë hapësirë për dhunë apo dëmtime të çfarëdo lloji. Ai i udhëzon ata që dëshirojnë të martohen, që të zgjedhin partnerët e tyre sipas kriterëve të caktuar, dhe gjithashtu qartëson të drejtat dhe detyrat midis bashkëshortëve, ku një nga përgjegjësitë më të rëndësishme është bashkëpunimi në edukimin e fëmijëve, ruajtja e lidhjeve farefisnore dhe lidhjeve të gjakut.

⁸ el-Muminun: 96.

1. Kriteret për zgjedhjen e partnerit nga çdo palë

Në procesin e krijimit të familjes, zgjedhja e partnerit është hapi i parë dhe më i rëndësishëm. Islami udhëzon që kjo zgjedhje të bëhet mbi bazën e besimit dhe karakterit të mirë, pasi këto janë elementet thelbësore për ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme familjare. Feja dhe morali i mirë i personit garantojnë që veprimet e tij do të jenë në përputhje me vlerat islame, të cilat janë në harmoni me natyrën e njeriut.

Pejgamberi a.s. ka theksuar rëndësinë e karakterit të mirë në zgjedhjen e partnerit duke thënë:

*“Më të përsosurit e besimtarëve në besim janë ata me karakterin më të mirë, dhe më të mirët prej jush janë ata që janë më të mirët me gratë e tyre.”*⁹

Ai gjithashtu ka këshilluar që të zgjedhet partneri me besim të fortë fetar, pasi kjo sjell lumturi në jetën bashkëshortore.

*“Zgjidhni gruan që ka besim, do të jeni të lumtur.”*¹⁰

Po ashtu, Pejgamberi a.s. ka thënë:

*“Nëse ju vjen një burrë me fenë e të cilit jeni të kënaqur, martohu me të.”*¹¹

Prandaj, feja kërkohet nga një grua, sepse ajo është nderi i burrit dhe nëna e fëmijëve të tij, ndërsa feja kërkohet nga burri, sepse ai është udhëheqësi i familjes, mbrojtësi i saj dhe përgjegjës për të.

Një tjetër mënyrë për të siguruar stabilitetin e familjes është përputhshmëria mes bashkëshortëve në aspektin shoqëror, moral dhe intelektual, e njohur si *el-kefaetu*. Kjo përputhshmëri është thelbësore gjatë martesës dhe mbështetet në hadithin e transmetuar nga Aishja r.a., ku Pejgamberi a.s. thotë:

*“Zgjedhni për farën tuaj, martohuni me kufu”*¹² dhe *martojani atyre*”¹³.

Mungesa e kësaj përputhshmërie mund të shkaktojë konflikte dhe të çojë në prishjen e harmonisë familjare. Familja e ndërtuar mbi parimin e barazisë është më e fortë dhe më e qëndrueshme përballë sfidave të jetës. Përndryshe, mungesa përputhshmërisë ndërmjet bashkëshortëve mund të dëmtojë komunikimin dhe harmoninë mes tyre, duke çuar në largim, braktisje, prishje shtëpie dhe humbje të fëmijëve.

Martesa në Islam bëhet me pëlqimin e ndërsjellë të dy palëve, që fillon me vullnetin e dy individëve për të krijuar një lidhje dhe ky pëlqim është thelbësor për sigurinë dhe stabilitetin e familjes. Kjo kontratë e shenjtë, e përmendur në Kuranin fisnik si “besë e fortë”, ka efekte të thella në individ dhe shoqëri. Pëlqimi i lirë i të dy palëve është thelbësor, pasi një martesë e detyruar

⁹ Ibn Hibani, nr: 4176. Shejh Shujabi thotë: “Zingjiri transmetues i tij është i mirë”.

¹⁰ el-Buhari, nr: 509; Muslimi, nr: 1466.

¹¹ et-Tirmidhi, nr: 1085, dhe thotë: “Ky hadith është i mirë”.

¹² el-Kufu do të thotë: barazia e burrit me gruan në çështje të veçanta. Çështjet të cilat merren në konsideratë në el-kefaetu janë: Islami, devotshmëria, prejardhja, liria, profesioni dhe pasuria. Shih: el-Ihtijar, 3/98-99, el-Bahr, 3/137, Mexhma el-Enhur, 1/339, Hashijetu ala ed-Durri el-Muhtar, 3/86.

¹³ el-Mustedrek, nr: 2687, 2/177. el-Hakimi thotë: “Senedi i këtij hadithi është sahih”.

mund të shkaktojë probleme serioze dhe të çojë në dhunë e konflikte. Pejgamberi a.s. ka thënë:

*“E pamartuara (el-ejjim) është me meritore ndaj vetvetes sesa kujdestari i saj, ndërsa virgjëresha pyetet për vetveten. Heshtja e saj është leja e saj.”*¹⁴

Këtë e konfirmon gjithashtu hadithi i Ibn Abasit r.a., se një vajzë e virgjër erdhi te Pejgamberi a.s. dhe i tregoi se babai i saj e kishte martuar pa dëshirën e saj, kështu që Pejgamberi a.s. i dha asaj të drejtën e përzgjedhjes.¹⁵

Fillimi i martesës duhet të bazohet në dëshirën e përbashkët të burrit dhe gruas për të pranuar dhe vazhduar marrëdhënien, duke ngushtuar kështu mundësitë e mosmarrëveshjeve dhe mbyllur derën e agresionit, sepse njeriu është më i prirë të përballojë pasojat e zgjedhjeve të veta të lira, ndryshe nga ato që i imponohen.

2. Sqarimi i të drejtave dhe detyrimeve midis bashkëshortëve

Islami ka përcaktuar të drejtat dhe detyrat ndërmjet bashkëshortëve për të siguruar një marrëdhënie të qëndrueshme. Marrëdhënia bashkëshortore në Islam bazohet në parimin e barazisë së të drejtave dhe detyrimeve. Zoti i Madhëruar thotë gjithashtu:

“Edhe atyre (grave) u takon e drejta sikurse edhe përgjegjësia në bashkëshortësi”.¹⁶

Ibn Kethiri, duke komentuar këtë ajet, shprehet se gratë kanë të drejta ndaj burrave sikurse burrat ndaj grave, dhe secili duhet t'i përmbushë tjetrit atë që i takon në mënyrë të arsyeshme dhe të drejtë.¹⁷ Kjo do të thotë se marrëdhënia ndërmjet bashkëshortëve nuk është një marrëdhënie e pasigurt, por një marrëdhënie e rregulluar nga parimet e Islamit, e cila synon ruajtjen e harmonisë së brendshme.

Kjo barazi manifestohet përmes trajtimit të ndërsjellë me mirësjellje, respekt dhe mirëkuptim, plotësimi të të drejtave dhe mbajtjes së përgjegjësisë që ata kanë ndaj njëri-tjetrit sipas teksteve të sheriatit.

Marrëdhënia mes bashkëshortëve forcohet gjithashtu përmes parimit të Shura (konsultimit), ku bashkëshortët menaxhojnë jetën familjare së bashku, duke rritur besimin dhe respektin reciprok, duke krijuar kështu një mjedis të shëndetshëm për rritjen e fëmijëve. Ky proces shmang qëndrimet e njëanshme dhe e bën familjen të funksionojë si një trup i vetëm, ku çdo pjesë e saj kontribuon për të përmbushur nevojat e familjes, dhe çdo dëm që i ndodh njërit prej anëtarëve ndikon në të gjithë familjen.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është roli i burrit si kujdestar i familjes, i cili ka përgjegjësinë të trajtojë gruan me dashuri dhe respekt, duke siguruar

¹⁴ Muslimi, nr: 1421.

¹⁵ Ahmedi, nr: 2469. Shejh Shuajbi thotë: “Zingjiri transmetues i tij është i saktë sipas kritereve të Buhariut”.

¹⁶ el-Bekare: 228.

¹⁷ Tefsir Ibn Kethir, 1/609.

furnizimin e saj dhe përmbushur kërkesat e familjes. Kjo përgjegjësi është e lidhur ngushtë me rolin e gruas si kujdestare e shtëpisë dhe e fëmijëve. Gruaja duhet të jetë e bindur dhe të veprojë brenda kufijve të mirësjelljes dhe parimeve të përcaktuara nga Kurani dhe Suneti, duke kontribuar në ekuilibrin e marrëdhënieve familjare. Nëse secili bashkëshort e di rolin e tij dhe e respekton atë, grindjet dhe përplasjet do të shmangen, dhe dashuria dhe harmonia do të mbizotërojnë brenda familjes.

Të gjitha këto më sipër vërtetohen nga Kurani fisnik, ajetet e të cilit përcaktojnë se marrëdhënia mes bashkëshortëve bazohet në prehje të gruas. Zoti i Madhëruar thotë:

“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë”.¹⁸

Ky ajet thekson se martesë është një shenjë e prehjes dhe qetësisë për të dy bashkëshortët, dhe kjo qetësi arrihet kur secili kupton dhe respekton detyrën dhe përgjegjësitë e tij në marrëdhënien martesore. Kur secili bashkëshort e njeh dhe e përmbush detyrën e tij me dashuri dhe përkushtim, marrëdhënia mes tyre forcohet dhe paqja dhe harmonia mbizotërojnë, duke krijuar një familje të shëndetshme dhe të qëndrueshme.

3. Bashkëpunimi në rritjen e fëmijëve

Familja është bërthama e shoqërisë, dhe në qendër të saj qëndrojnë fëmijët, të cilët janë fryt i martesës dhe gëzimi i jetës. Në këtë kontekst, roli i prindërve në edukimin dhe rritjen e fëmijëve merr një rëndësi të veçantë.

Në islam, përgjegjësia e rritjes së fëmijëve është një detyrë e shenjtë që ndahet mes burrit dhe gruas. Secili prej tyre ka role specifike, por plotësuese. Burri mban përgjegjësinë kryesore për sigurimin e nevojave materiale dhe mbrojtjen e familjes, ndërsa gruaja ka një rol thelbësor në edukimin, kujdesin emocional dhe zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve. Kjo ndarje përgjegjësisë është thelbësore për ruajtjen e stabilitetit dhe harmonisë brenda familjes.

Nëse secili prej bashkëshortëve e kupton dhe e përmbush rolin e tij me dashuri, përkushtim dhe në përputhje me mësimet e Kuranit dhe Haditheve të Pejgamberit a.s., familja do të funksionojë pa probleme dhe shqetësime. Nuk ka vend për dhunë, stres apo pasiguri, por për dashuri, mirëkuptim dhe bashkëpunim të ndërsjellë. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.”¹⁹

Ky ajet na kujton përgjegjësinë e madhe që kemi ndaj familjes sonë dhe rolin e rëndësishëm që luajmë në sigurinë shpirtërore dhe fizike të atyre që kemi në kujdes. Po ashtu, Pejgamberi a.s. thotë:

¹⁸ er-Rrum: 21.

¹⁹ et-Tahrim: 6.

“Të gjithë ju jeni kujdestarë dhe të gjithë ju jeni përgjegjës për ato që keni në kujdes. Prijësi (kryetari) është kujdestar për popullin e tij dhe është përgjegjës për ta. Burri është kujdestar për familjen e tij dhe është përgjegjës për ta. Gruaja është kujdestare për fëmijët dhe është përgjegjëse për ta. Të gjithë ju jeni përgjegjës për atë që keni në kujdes.”²⁰

Ky parim është i barabartë për burrin dhe gruan, secili nga ata kanë përgjegjësinë për edukimin dhe mbrojtjen e fëmijëve. Çdo individ në një familje ka një rol të rëndësishëm dhe përgjegjësi të qarta. Kur secili përmbush këtë rol me dashuri, përkushtim dhe respekt për urdhrat e Allahut, familja do të lulëzojë dhe do të jetë një burim paqeje dhe harmonie. Rritja e fëmijëve, mbrojtja e lidhjeve farefisnore dhe ruajtja e lidhjeve familjare janë aspekte thelbësore për krijimin e një shoqërie të shëndetshme dhe të qëndrueshme, që do të sjellë bekim dhe lumturi për të gjithë.

Pjesa e dytë: Qasja e Islamit ndaj dhunës pas ndodhjes së saj brenda familjes

Të gjitha aspektet e mëparshme të përmendura ofrojnë një mbrojtje për familjen ndaj përhapjes së dhunës dhe ndikojnë në ruajtjen e stabilitetit të saj. Mirëpo, ndonjëherë, për shkak të dobësisë, injorancës, ose edhe qëllimisht, ndodhin dhunë dhe konflikte që kërcënojnë paqen dhe harmoninë brenda familjes. Kjo mund të çojë në çrregullimin e jetës shoqërore dhe, nëse nuk ndërhyhet, mund të shkaktojë pasoja të dëmshme për individët dhe për shoqërinë në përgjithësi. Në këtë kontekst, Islami ofron një qasje gjithëpërfshirëse për trajtimin e këtyre situatave, duke vënë theksin në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë paqësore. Legjislacioni islam ka përcaktuar masa dhe udhëzime të qarta për të kontrolluar dhunën, për të mbyllur rrugët që çojnë në të dhe për të siguruar stabilitetin e familjes. Për këtë qëllim, Islami ofron një kuadër të qartë për trajtimin e dhunës, duke ofruar mundësi për pajtim ose, në rast se kjo është e pamundur, duke bërë zgjidhjen e lidhjes martesore, në mënyrë që të ruhet dinjiteti dhe siguria e individëve.

Një: Masat për kontrollimin e dhunës brenda familjes

Jeta brenda familjes nuk është e mbrojtur nga luhatjet dhe konfliktet, që mund të ndodhin si pasojë e faktorëve të jashtëm apo të brendshëm. Këto konflikte mund të përfshijnë një gamë të gjerë arsyesh, të cilat ndodhin kur njëri ose të dy bashkëshortët kanë dorë në shfaqjen e mosmarrëveshjes dhe konfliktit mes tyre dhe pasojat që vijnë prej tij. Martesa, e cila është themeluar për të ofruar dashuri, mëshirë dhe paqe, mund të devijojë nga qëllimi bazë i saj dhe të çojë në grumbullimin e tensioneve dhe mosmarrëveshjeve, që mund

²⁰ Ibn Hibani, nr: 4489. Shejh Shuajbi thotë: “Zingjiri transmetues i tij është i saktë sipas kritereve të Buhariut dhe Muslimit”.

të kërcënojnë qetësinë dhe stabilitetin e familjes. Në këto situata, Islami ofron udhëzime të qarta për t'u përballur me këto situata dhe për të riparuar marrëdhëniet mes bashkëshortëve. Ky proces mund të realizohet në dy mënyra kryesore: përmes pajtimit dhe përpjekjeve për të rikthyer harmoninë ose, nëse kjo është e pamundur, atëherë duke ndërprerë lidhjen martesore për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të familjes dhe të individëve të tjerë.

1. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve kur ato ndodhin ndërmjet bashkëshortëve

Në rastet kur lindin mosmarrëveshje mes bashkëshortëve, hapi i parë është dialogu dhe komunikimi i hapur. Nëse kjo nuk sjell rezultate, Islami rekomandon ndërhyrjen e ndërmjetësuesve (arbitrave) nga familjet e të dy palëve. Këta ndërmjetësues kanë për detyrë të dëgjojnë të dy palët dhe të përpiqen të gjejnë një zgjidhje që ruan unitetin familjar. Zoti thotë në Kuran:

“Nëse ndonjë grua i frikësohet largimit ose ftohjes së burrit të vet ndaj asaj, atëherë nuk gabojnë po që se bëjnë mes vete ndonjë mbarim (pajtim). Pajtimi është më i dobishmi...”²¹

Roli i ndërmjetësuesve (arbitrave), të cilëve u drejtohet për pajtimin ndërmjet bashkëshortëve, është që t'i afrojnë pikëpamjet e palëve në mosmarrëveshje, në përpjekje për ta rikthyer jetën familjare në normalitet dhe në qëllimin e krijimit të saj. Nëse pajtimi është i pamundur, ndërmjetësuesit mund të bëjnë ndarjen e bashkëshortëve me autorizimin e të dyve.²² Sipas shkollës juridike malikite, ndërmjetësuesit kanë të drejtë të marrin vendimin për ndarjen e bashkëshortëve edhe pa autorizimin e tyre.²³ Ky veprim është një masë për të shpëtuar familjen nga pasojat e dhunës dhe përçarjes. E gjithë kjo bëhet në përpjekje për t'i dhënë fund përçarjes dhe zgjidhjen e konfliktit, përhapja dhe vazhdimi i të cilit çon në dëmtim të bashkëshortëve dhe fëmijëve. Prandaj, qëllimi i pajtimit është rivendosja e sigurisë në familje, dhe rezultati i tij është ose vazhdimi i jetës bashkëshortore në një atmosferë dashurie, mëshire dhe tolerance, ose zgjidhja e tij për t'i dhënë fund konfliktit dhe për të parandaluar dëmtimin e tij dhe mosmarrëveshjet e grindjet që e shoqërojnë atë.

2. Zgjidhja e lidhjes martesore

Kur të gjitha përpjekjet për pajtim dështojnë dhe situata bëhet e padurueshme, Islami lejon zgjidhjen e lidhjes martesore si opsionin e fundit. Kjo zgjidhje, megjithëse e padëshirueshme, njihet si më e mira në rrethana të caktuara, veçanërisht kur vazhdimi i martesës mund të shkaktojë dëm psikologjik ose fizik për palët, përfshirë fëmijët. Studime bashkëkohore në fushën e sociologjisë mbështesin këtë qasje, duke treguar se fëmijët vuajnë më shumë nga një mjedis i tensionuar familjar sesa nga ndarja e prindërve kur kjo bëhet

²¹ en-Nisa: 128.

²² Fet'hu el-Kadir, 4/244; Sherh Muhtesar et-Tahavi, 4/457.

²³ el-Mudevineh, 2/270; Bidajetu el-Muxhtehid, 3/117, etj.

në mënyrë të civilizuar. Për këtë arsye, ligji islam ka përcaktuar procedura të qarta për zgjidhjen e martesës, duke përfshirë mbrojtjen e të drejtave të të gjitha palëve të përfshira.

Nëse kjo është e nevojshme, Islami parashikon masa për zgjidhjen e martesës, qoftë nga ana e burrit apo me kërkesë të gruas. Shumë vendime janë ligjëruar për të hequr dëmin e shkaktuar bashkëshortëve, siç vërtetohet nga vendimet për “ila-në” dhe “dhihar-in” dhe të tjera, të cilat janë mjetet e legjislacionit islam në heqjen e konfliktit ndërmjet bashkëshortëve. Dëmi është i ndaluar dhe duhet të eliminohet, dhe në rastin e “dhihar-it” dhe “ila-së”, Sheriati kërkon që dëmi të largohet, duke ndaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e qëllimshme të gruas. Dispozitat e legjislacionit islam kërkojnë që sjelljet e tilla të refuzohen, pasi çojnë në grindje dhe urrejtje që mund të përhapen edhe tek fëmijët. Për këtë arsye, ndalimi i “dhihar-it” nuk mund të hiqet përveçse me kefaret dhe kufizimi i “ila-së” duhet të jetë me një periudhë të caktuar, që të arrijë qëllimin e disiplinës. Përndryshe, këto janë të ndaluara dhe kryesi i saj është mëkatar.

Dy: Kujdesi për familjen pas zgjidhjes së martesës

Islami i kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes dhe kujdesit ndaj anëtarëve të familjes, edhe pas zgjidhjes së martesës. Ky kujdes manifestohet në dy aspekte kryesore: përkujdesjen ndaj gruas dhe mbrojtjen e interesave të fëmijëve. Legjislacioni islam ka vendosur rregulla të qarta për të siguruar që të drejtat e të gjitha palëve të respektohen dhe që periudha pas ndarjes të menaxhohet në mënyrë të drejtë dhe të denjë.

1. Kujdesi ndaj gruas pas divorcit

Pas ndarjes, Islami i njej gruas një sërë të drejtash dhe garancish që synojnë të sigurojnë stabilitetin dhe dinjitetin e saj. Gjatë periudhës së pritjes (iddeh), e cila zgjat tre cikle menstruale ose tre muaj, dhe në rastin e një gruaje shtatzënë deri në lindjen e fëmijës, burri ka për detyrë të sigurojë strehim dhe mirëmbajtje të plotë për të. Kjo vlen si në rastet e ndarjes së kthyeshme, ashtu edhe të pakthyeshme, pavarësisht nëse gruaja është shtatzënë apo jo.²⁴ Argument për obligimin e furnizimit dhe vendstrehimit të gruas se divorcuar, qoftë me divorc të pakthyeshem, përfundimtarë apo jo përfundimtarë, apo shtatzënë, kemi ajetet:

“Ato (gratë e lëshuara), sipas mundësisë suaj, i vendosni në ndonjë vend ku banoni ju.”²⁵ ***“Në qoftë se ato janë shtatzëna, atëherë furnizoni ato derisa ta heqin barrën e tyre.”***²⁶

Kjo periudhë shërben jo vetëm si një kohë reflektimi dhe mundësi për pajtim, por edhe si një mekanizëm për të siguruar që gruaja të ketë mbështetjen e nevojshme financiare gjatë kësaj faze tranzitore.

²⁴ el-Bedai, 4/16, el-Ihtijar, 4/8-9, etj.

²⁵ et-Talak: 6.

²⁶ et-Talak: 6.

2. Kujdesi ndaj fëmijëve pas divorcit

Fëmijët janë ndër më të prekurit në rastet e ndarjes së prindërve, dhe Islami i vendos ata në qendër të kujdesit dhe mbrojtjes. Sistemi islam i kujdestarisë është ndërtuar mbi parime që mbështesin zhvillimin e shëndetshëm dhe të drejtë të fëmijës, si emocionalisht, ashtu edhe fizikisht. E drejta e kujdestarisë për fëmijët në moshë të vogël i jepet nënës, për shkak të lidhjes së fortë emocionale dhe nevojës për përkujdesjen e saj. Kjo mbështetet në një hadith të të Dërguarit të Allahut, a.s., ku ai i tha një gruaje që kërkoi kujdestarinë e fëmijës së saj pas ndarjes:

“Ti ke më shumë të drejtë për të (fëmijën) derisa të martohesh (sërish).”²⁷

Ky hadith tregon rëndësinë që ai i kushtonte lidhjes nënë-fëmijë dhe të drejtave emocionale të fëmijës.

Ndërkohë, babai mban përgjegjësinë për mbështetjen financiare të fëmijës, duke përfshirë shpenzimet për ushqim, veshmbathje, strehim, arsimim dhe kujdes shëndetësor. Kjo ndarje e balancuar e përgjegjësisë synon të sigurojë që fëmijët të vazhdojnë të marrin kujdesin dhe mbështetjen e nevojshme nga të dy prindërit, pavarësisht ndarjes së tyre. Përmes kësaj qasje të ekuilibruar, Islami përpiqet të minimizojë ndikimin negativ të ndarjes në mirëqenien psikologjike dhe emocionale të fëmijëve, duke garantuar një ambient të shëndetshëm për rritjen dhe zhvillimin e tyre.

Conclusion

Islam's approach to domestic violence is comprehensive and multidimensional. At the preventive level, Islam emphasizes fundamental values such as mercy, respect, and mutual understanding, considering these as foundations of family relationships. Through clear guidelines for partner selection, establishing mutual rights and responsibilities, and emphasizing the importance of open communication, Islam creates a strong foundation for violence prevention.

In cases where conflicts arise, Islam offers a structured system for dispute resolution, ranging from direct dialogue to mediation and, as a last resort, civilized separation. This holistic approach demonstrates that Islamic teachings not only do not tolerate domestic violence but also provide concrete tools for building and maintaining healthy family relationships in accordance with divine principles and human needs.

Recensentë:

Dr. Ajni Sinani

Dr. Violeta Smajlaj

²⁷ Ahmed, nr: 6707, 11/310-311, Shejh Shuajbi thotë: “Hadithi është i mirë”.